Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 të datës 4 Qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28 e datës 4 Qershor 2008, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10 e datës 3 Prill 2019, nenit 5 pika 1.paragrafi 1.3, nenit 6 paragrafi 3, nenit 13, nenit 21 paragrafi 5 dhe 6 dhe nenit 22 të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës_____2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM
PËR MIRATIMIN E OFERTËS "BIRRA PEJA" TË PËRZGJEDHUR NGA KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS NË ZK-KONJUH

Neni 1

MIRATOHET oferta e përzgjedhur nga Komisioni Vlerësues për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë:

1. "Birra Peja" me nr.biznesit 811277939 adresa: Rr."Nexhdet Basha" nr.160–Pejë, përfaqësuar nga Drejtori menaxhues Ardian Jusufi, shfrytëzuese e pronave të paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale-Konjuh, Komuna e Lipjanit.
2. Pronat e paluajtshme e Komunës, gjenden në ZK Konjuh, të përshkruara sipas evidencave përkatëse kadastrale, si në tabelën në vijim:

Nr	Pronar	Parcela Kadastrale	Zona Kadastrale	Sipërfaqe për shfrytëzim m^2
1.	Komuna Lipjan	P-71409036-00166-7 P-71409036-00164-20	Konjuh	12357m^2 17643m^2

3. Shfrytëzimi i pronës komunale do të jetë për 99 vite nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.
4. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, destinohet kryesisht për ushtrimin e veprimtarisë prodhuese "Fabrikë për prodhimin e lëngjeve" sipas projektit të parashtruar nga ofertuesi "Birra Peja". Kjo veprimtari është në përputhje me destinimin e përcaktuar të hapësirës sipas Hartes Zonale të Komunës.

5. Interesi ekonomik i Komunës së Lipjanit, lidhur me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të këtyre pronave komunale, është se oferta e përzgjedhur që ka të bëjë me:
   - Veprimtari prodhuese (Kjo veprimtari konsiderohet me interes dhe me prioritet për Komunën),
   - Vlerën më të lartë investive prej 33,450,966.93mil.€, vlera investive përfshinë ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisjet e fabrikës dhe objekteve përcjellëse sipas projektit të prezantuar,
   - Sipërfaqen më të madhe ndërtimore prej 30768.9 m^2,
   - Numrin më të lartë të të punësuarëve sipas investimit–deri në 750 punonjës,
   - Afatin e arsyeshëm kohor për realizimin e projektit prej 36 muajve.
6. Pronat e dhëna në shfrytëzim dhe ushtrimi i veprimtarisë prodhuese do të kenë ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik nga ushtrimi i aktiviteteve afariste. Zhvillimet në pronë do të kanë ndikim në rritjen e konsiderueshme të vlerës së pronës, përfitimin e vazhdueshëm të tatimit në pronë nga Komuna dhe punësimin e rregullt të qindra punonjësve nga Komuna e Lipjanit dhe më gjërë.

Neni 2

Të drejtat dhe obligimet e palëve do të rregullohen me kontratë të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe shfrytëzuesit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas përfundimit të afatit të kontratës, prona i kthehet titullarit të pronës- Komunës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori Pronësoro-Juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Inspekcionit dhe Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

A r s y e t i m

Baza juridike për ta propozuar dhe miratuar këtë propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, të Rregullores QRK NR.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr-462/01-4912 të datës 28.01.2025.

Bazuar në aplikacionin dhe dokumentet e tjera përcjellëse si në shkresat e lëndës të datës 07.07.2026 me numër të protokollit 1Nr.462/01-30744 të ofertuesit "Birra Peja" me nr. biznestit 811277939 adresa Rr."Nexhdet Basha Nr.160–Pejë, përfaqësuar nga Drejtori menaxhues Ardian

Jusufi, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës nga ana e Komisionit Vlerësues, është vlerësuar se ofertuesi i ka plotësuar kushtet për marrjen në shfrytëzim të parceles komunale P-71409036-00166-7 me sipërfaqe prej 12357m^2 dhe parcelen P-71409036-00164-20 me sipërfaqe prej 17643m^2 në ZK- Konjuh, sipas Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës 15Nr-462/01-4912 të datës 28.01.2025, dhe të Njoftimit Publik të datës 22.06.2026, 1Nr.463/02-27623 për dhëien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës ZK-Konjuh.

Bazuar në Njoftimin e datës 15.09.2026, 1Nr.462/01-48115 për përzgjedhjen e ofertës sipas Njoftimit publik 1Nr.463/02-27623 datë 22.06.2026 të Komisionit Vlerësues, është përzgjedhur ofertuesi "Birra Peja" me nr. biznestit 811277939 adresa Rr."Nexhdet Basha Nr.160–Pejë, përfaqësuar nga Drejtori menaxhues Ardian Jusufi, lidhur me realizimin e projektit "Fabrikë për prodhimin e lëngjeve" për shfrytëzimin e pronave të paluajtshme të Komunës në afat prej 99 viteve për parcelën kadastrale P-71409036-00166-7 me sipërfaqe prej 12357m^2 dhe P-71409036-00164-20 sipërfaqe prej 17643m^2 në ZK- Konjuh, ashtu siç përcaktohet në nenin 1 pika 2 e këtij propozim-Vendimi.

Në raportin e Komisionit Vlerësues të datës 08.10.2026, 1Nr.052/01-51282 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës mbi rivlerësimin e ofartave të pranuara bazuar në Njoftimin publik 22.06.2026, 1Nr.463/02-27623, Komisionit Vlerësues ka zbatuar procedurat për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092.

Prandaj bazuar në arsyet e theksuara më lartë dhe konform dispozitave ligjore në fuqi, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij propozim-Vendimi.

Nr. 01-462/01-52695

Lipjan, më 19.10.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

01-462/01-48145

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lipjan, me datë 15.09.2026

Në mbështetje të nenit 19 par 1 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Gazeta zyrtare 2019/10 data 03.04.2019, Vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës - ZK Konjuh Nr-15-462/01-4912, të datës 28.01.2025, Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës, i themeluar me Vendimin Nr.15-020/04-13700, të datës 24.03.2026, në mbledhjen e mbajtur me datën 15.09.2026 pas rivlerësimit të ofertave bazuar në Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave Nr.01-462/01-47021 të dates 08.09.2026 vendosi të shpallë:

NJOFTIMIN
PËR PËRZGJEDHJEN E OFERTËS

I. Oferta më e favorshme ekonomike e përzgjedhur sipas Njoftimit publik Nr. 01-463/02-27623 të datës 22.06.2026, për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës – ZK në Konjuh është:

"Birra Peja" me oferten e paraqitur me numër të protokollit 01-462/01-30744 e parashtruar me datën 07.07.2026 e cila mori 93.04 pikë nga 100 të mundshme.

II. Palët e pakënaqura nga procesi i rivlerësimit të ofertave nga Komisioni, prej ditës së pranimit të njoftimit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë brenda afatit prej shtatë (7) ditë kalendarike në Komisionin e ankesave.

III. Rivlerësimi i ofertave parqitet në shtojcë të këtij Njoftimi.

Anëtarët e Komisionit:

Latif Ramadani
Imri Semetishti
Venhar Agushi
Besim Jusufi
Bekim Krasniqi

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Shtojcë e Njoftimit për përzgjedhjen e ofertës pas rivlerësimit të ofertave

Ofertuesi	*Kriteret vlerësuese*	*Vlera e ofruar*
Oferta me numër protokolli 01-462/01-30744 e dorëzuar me datën 07.08.2026.	- Vlera investive për ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisje sipas projektit ideor	33,450,966.93€.
	- Numri i të punësuarëve sipas investimit për realizimin e projektit – deri në 750 punonjës	deri në 750 punonjës
	- Afati kohor për realizimin e projektit –.	36 muaj
	- Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën sipas listimit të veprimtarive në pikën II të Njoftimit Publik	Veprimtari prodhuese: prodhim i lëngjeve
	- Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën, duke përfshirë sipërfaqen ndërtimore – 30778 m2.	30778 m2.
	- Projekti ideor	Sipas kërkesave të HZK dhe pikes 8 të kritereve teknike
Kjo ofertë i plotëson të gjitha kriteret administrative. Pas vlerësimit të kritereve teknike vlerësohet se është më e favorshmja ekonomikisht. Vlerësohet me 93.04 pikë nga 100 të mundshme.		
Oferta me numër protokolli 01-462/01-30637 e dorëzuar me datën 07.08.2026.	- Vlera investive për ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisje sipas projektit ideor	25,097,836.05€.
	- Numri i të punësuarëve sipas investimit për realizimin e projektit	deri në 450 punonjës
	- Afati kohor për realizimin e projektit	30 muaj.
	- Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën sipas listimit të veprimtarive në pikën II të Njoftimit Publik – Shërbime – depo, servisim dhe administratë;	Shërbime: depo, servisim dhe administratë;
	- Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën, duke përfshirë sipërfaqen ndërtimore –	25000 m2.
	Projekti ideor	Pjesërisht sipas pikes 8 të kritereve teknike
Kjo ofertë i plotëson të gjitha kriteret administrative dhe në aspektin e kritereve vlerësnes është poentuar me 81.95 pikë nga 100 të mundshme.		

Oferta me numër protokolli 01-462/01-30646 e dorëzuar me datën 07.08.2026.	- Vlera investive për ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisje sipas projektit ideor	19.477.184€
	- Numri i të punësuarëve sipas investimit për realizimin e projektit	Deri në 240 punonjës
	- Afati kohor për realizimin e projektit	10 vite
	- Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën sipas listimit të veprimtarive në pikën II të Njoftimit Publik –	Qendër industriale e prodhimeve të lehta dhe inovatoive (industri e lëndës së parë, industri e prodhimeve të lehta dhe inovative si dhe shërbime profesionale, financiare dhe të informacionit.
	- Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën, duke përfshirë sipërfaqen ndërtimore	15000 m2
	Projekti ideor	Pjesërisht sipas pikes 8 të kritereve teknike
Kjo ofertë nuk i ka plotësuar kriteret administrative, përkatësisht pikën III/1. nr. rendor 4 dhe 5 të kritereve administrative të Njoftimit Publik.Po ashtu në aspektin financiar kjo ofertë është më pak e favorshme se sa dy ofertat e para.		
Oferta me numër protokolli 01-462/01-30758 e dorëzuar me datën 07.08.2026.	- Vlera investive për ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisje sipas projektit ideor	Rreth 20 milion € vlera fillestare. Ka mospërputhje me të dhënat në projektin ideor dhe planin e shkurtër të biznesit
	- Numri i të punësuarëve sipas investimit për realizimin e projektit	235 punonjës
	- Afati kohor për realizimin e projektit	– 30 muaj.
	- Lloji i investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën sipas listimit të veprimtarive në pikën II të Njoftimit Publik	– Prodhim i paneleve të drurit dhe llajsneve të drurit;
	- Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën, duke përfshirë sipërfaqen ndërtimore .	7847 m2
	Projekti ideor	Pjesërisht sipas pikes 8 të kritereve teknike
Kjo ofertë nuk i ka plotësuar kriteret administrative, përkatësisht pikën III/1. nr. rendor 9 të Njoftimit Publik.Po ashtu në aspektin financiar kjo ofertë është më pak e favorshme se sa ofertat tjera.		

Vlerësimet e kritereve janë bërë në bazë të formulave përkatëse matematikore dhe krahasuese të përcaktuara paraprakisht.

Më 15.09.2026

Anëtarët e Komisionit:

Latif Ramadani

Imri Semetishti

Venhar Agushi

Besim Jusufi

Bekim Krasniqi

09.10.2026
01-052/01-51282

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
MUNICIPALITY OF LIPJAN
SKUPŠTINA LIPLJAN

Për: Imri AHMETI, Kryetar i Komunës,

Daut AZEMI, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Nga: Imri Semetishti, Kryesues i Komisionit për vlerësimin e ofertave

Lënda: Dorëzimi i Raportit për vlerësimin e ofertave

Të nderuar,

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr-15-462/01-4912 të datës 28.01.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës në ZK-Konjuh, në emër të Komisionit Vlerësues, të themeluar me Vendimin Nr.15-020/04-13700 të datës 24.03.2026 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK - Konjuh, ju dorëzojë:

1. ***Raportin e vlerësimit të ofertave sipas Njoftimit Publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026 dhe rekomandimin për procedimin e mëtutjeshëm të lëndës për marrjen e Vendimit lidhur me pronat në ZK në Konjuh.***

Me këtë shkresë ju dorëzojë edhe:

1. Vendimin e Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr-15-462/01-4912 të datës 28.01.2025.

2. Vendimin Nr.15-020/04-13700 të dates 24.03.2026 për themelimin e Komisionit vlerësues;

3. Njoftimin publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026.

4. Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr. 01-462/01-48115 i datës 15.09.2026 dhe shtojcën për rivlerësimin e ofertave.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	8 tetor 2026
Për:	Z. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit të Komunës Z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës së Lipjanit Z. Gafurr Hetemi, Shef i Sektorit pronësor - juridik
Nga:	Anëtarët e Komisionit Vlerësues të themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-020/04-13700 të datës 24.03.2026
Lënda:	Raporti i Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës – ZK Konjuh për vlerësimin e ofertave sipas Njoftimit Publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026

Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr-15-462/01-4912 të datës 28.01.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së Komunës në ZK-Konjuh, Komisioni Vlerësues i themeluar me Vendimin Nr.15-020/04-13700 i dates 24.03.2026 për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në ZK - Konjuh, ju dorëzon:

RAPORTIN
E VLERËSIMIT TË OFERTAVE SIPAS NJOFTIMIT PUBLIK Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026 – ZK KONJUH

Në zbatim të Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr-15-462/01-4912 të datës 28.01.2025 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të Komunës ZK-Konjuh, me Njoftimin Publik Nr.01-463/02-27623 të dates 22.06.2026 janë shpallur për dhënie në shfrytëzim pronat komunale:

P-71409036-00166-7, në sipërfaqe prej 12357 m^2; dhe
P-71409036-00166-20, në sipërfaqe prej 17643 m^2;

Komisioni Vlerësues pas përmbylljes së afatit për aplikim të përcaktuar me Njoftimin Publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026, me datën 08.07.2026 ka pranuar katër (4) oferta:

1. Oferta e parashtruar nga Kolegji "UBT" me numër protokolli 01-462/01-30646 e dorëzuar me datën 07.07.2026.

2. Oferta e parashtruar nga "Birra – Peja" me numër protokolli 01-462/01-30744 e dorëzuar me datën 07.07.2026.

3. Oferta e parashtruar nga "Averex" SH.P.K. me numër protokolli 01-462/01-30758 e dorëzuar me datën 07.07.2026.

4. Oferta e parashtruar nga "Tyres Group Kosova" me numër protokolli 01-462/01-30637 e dorëzuar me datën 07.07.2026

Ofertat janë vlerësuar sipas procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe kriteret e përcaktuara me Njoftimin Publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026.

Në procesin e vlerësimit, Komisioni ka mbajtur dhjetë (10) takime pune, duke përfshirë edhe takimet për rivlerësimin e ofertave bazuar në Vendimin e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave Nr.01-462/01-47021 të datës 08.09.2026.

Komisioni për vlerësimin e ofertave ka konstatuar se dy oferta kanë plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara me Njoftimin Publik dhe ato janë vlerësuar në aspektin e kritereve teknike/vlerësuese.

Komisioni për vlerësimin e ofertave me datën 20.08.2026 ka publikuar Njoftimin për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-462/01-42088.

Në bazë të kritereve të përcaktuara fitues i pronave komunale është shpallur "Birra – Peja". Ky ofertues është vlerësuar me 93.04 pikë nga 100 të mundshme.

Ofertues "Tyres Group Kosova" është vlerësuar me gjithsejtë 81.95 pikë nga 100 të mundshme

Dy ofertuesit tjerë "Kolegji "UBT" dhe "Averex" SH.P.K. nuk i kanë plotësuar disa nga kriteret sipas pikës III/1. "Kriteret Administrative" të Njoftimit Publik Nr. 01-463/02-27623 të dates 22.06.2026. Njëkohësisht këto dy oferta ishin më pak të favorshme ekonomikisht krahasuar me oferten e përzgjedhur si fituese dhe oferten e parashtruar nga "Tyres Group Kosova" sa i përket kritereve vlerësuese. Ndëlidhur me këte janë vlerësuar 6 kritere, si:

- Vlerën investive për ndërtimin e ndërtesës dhe për pajisje sipas projektit ideor (max 25 pikë);
- Numrin e të punësuarëve sipas investimit për realizimin e projektit (max 15 pikë);
- Afatin kohor për realizimin e projektit (max. 10 pikë).
- Llojin e investimit që konsiderohet me interes dhe prioritet për Komunën sipas listimit të veprimtarive në pikën II të Njoftimit Publik (max 20 pikë).
- Përfitimi financiar dhe ekonomik për Komunën (max 20 pikë).
- Përputhshmërinë e projekti ideor me kriteret e përcaktuara me piken 8 të kritereve teknike (max 10 pikë).

Kriteret vlerësuese të përshkruara si më lartë kanë qenë të përcaktuara me pikën III/3 të Njoftimit Publik. Prandaj, para fillimit të vlerësimit të ofertave është përcaktuar metodologjia e vlerësimit dhe poentimit (peshimit) të kritereve. Mbi këtë bazë, vlerësimi i kritereve është bërë në bazë të formulave matematikore dhe krahasuese, me përjashtim të kriterit 6 ku për shkak të natyrës së këtij kriteri është aplikuar vlerësimi individual dhe pastaj është nxjerrë mesatarja e pikëve.

Ndaj Njoftimit për përzgjedhjen e ofertës Nr.01-462/01-42088 të datës 20.08.2026, ofertuesi "Kolegji UBT" ka parashtruar ankesë në Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Ky Komision e ka kthyer lëndën në rishqyrtim.

Pas përfundimit të procesit të ri-vlerësimit, Komisioni ka konfirmuar vlerësimet e njejta (paraprake) dhe fitues i pronave komunale është shpallur "Birra – Peja". Ky ofertues është vlerësuar me 93.04 pikë nga 100 të mundshme.

Pas rivlerësimit, Komisioni ka përgatitur "Njoftimin Nr. 01-462/01-48115 për përzgjedhjen e ofertës" i cili është publikuar me datën 15.09.2026 në faqen zyrtare të internetit të Komunës dhe me të njejtin janë njoftuar ofertuesit. Pjesë e Njoftimit është edhe "Shtojca" e Njoftimit për përzgjedhjen e ofertës pas rivlerësimit të ofertave.

Ofertuesi "Kolegji UBT" në procesin e zhvilluar sipas Njoftimit për përzgjedhjen e ofertes të dates 15.09.2026 ka parashtruar sërish ankesë. Mirëpo, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave me

shkresen Nr.01-462/01-50225 të datës 01.10.2026 ka njoftuar se ka nxjerrë Vendimin Nr.01-462/01 – 48115 të dates 01.10.2026 për përfundimin e procedures së shqyrtimit të Ankesës.

Duke pasur parasysh proceset e zhvilluara, Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr. 01-462/01-48115 i cili është publikuar me datën 15.09.2026, administrativisht është akt përfundimtar. Mbi këtë bazë, Komisioni për vlerësimin e ofertave e procedon këtë Raport dhe Rekomandon:

1. Kryetari i Komunës të procedoj administrativisht për përgatitjen e Vendimit për dhënien e pronës ZK Konjuh në shfrytëzim afatgjatë sipas rekonadimit të Komisionit Vlerësuese.

2. Kuvendi i Komunës të shqyrtoj propozim Vendimin për dhënien në shfrytëzim afatgjatë dhe të miratoj ate mbi bazën e vlerësimit për përfitimin më të lartë financiar dhe ekonomik për Komunën.

Në Shtojcë të këtij Raporti bashkëngjesim dokumentet:

1. Vendimin e Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës Nr-15-462/01-4912 të datës 28.01.2025.
2. Vendimin Nr.15-020/04-13700 të dates 24.03.2026 për themelimin e Komisionit vlerësues;
3. Njoftimin publik Nr.01-463/02-27623 të datës 22.06.2026.
4. Njoftimi për përzgjedhjen e ofertës Nr. 01-462/01-48115 i datës 15.09.2026 dhe shtojcën për rivlerësimin e ofertave.

Shënim: Të gjitha shkresat tjera lidhur me shqyrtimin e ofertave, duke përfshirë edhe ofertat e parashtruara nga palët do të dorëzohen në Sektorin për çështje pronësore – juridike.

Me respekt,

Anëtarët e Komisionit:

Imri Semetishti

Latif Ramadani

Venhar Agushi

Besim Jusufi

Bekim Krasniqi